




Gara nderkombetare finale matematikore Kengur 2022

08.05.2022, Maqedoni

Kategorija BENJAMIN (klasa e 6 dhe 7)



1.//Janë dhënë pesë vizatime në të cilat janë paraqitur matje të 5 lapsave. Njësia matëse është



1 cm. Sa prej këtyre lapsave janë të gjatë saktësisht 5 cm?

- (A) 1 (B) 2 (C) 3 (D) 4 (E) 5

2.Joana dhe miqtë e saj çdo javë luajnë futboll si ekip. Në fillim të çdo ndeshjeje ata vendosen gjithmonë në të njëjtën renditje. Atëherë numrat në këmishët e tyre lexohen nga e




majta në të djathtë si një numër i madh, dhe ata formojnë numrin më të madh të mundshëm. Kuidh qëndron në mes të asaj renditjeje të kolegëve të ekipit ?


- (A) Joana (B) Candy (C) Elyana (D) Nadine (E) Paula

3.// Një kuti në formë katrori është e përbërë nga katër lloje kutish që janë kube. Faqja anësore e kutive është e ngjyrosur me bojë. Sa prej kubeve nuk do të kenë bojë në vetvete?

- (A) 12 (B) 13 (C) 14
(D) 15 (E) 16





4. Në vizatim janë paraqitur tre katrorë të ndryshëm që kanë suprina 9 cm, 16 cm dhe 25 cm. Sa është suprina e trekëndëshit të hijëzuar.



- (A) 50 cm² (B) 40 cm² (C) 30 cm² (D) 20 cm² (E) 12 cm²

5. //Doki(djali) dhe Beki(vajza) shkojnë në shkollë sipas rrugëve që janë shënuar në vizatim(rrugët e bardha të labirintit). Rrugët e tyre asnjëherë nuk kalojnë nëpërmjet të njëjtës pikë të të gjitha pjesëve të mundshme të të gjitha rrugëve të tyre të mundshme për në shkollë. Cila prej rrugëve të shënuara mund të jetë rruga e Bekit?



6. Secila prej katër lodrave në peshore peshon një numër të plotë kilogramësh. Ato kanë pesha të ndryshme midis tyre. Pesha e tyre e përbashkët është 60 kilogramë (shiko vizatimin). Lodra e dytë më e rëndë peshon saktësisht 28 kilogramë. Sa lodra e tretë më e rëndë?

- (A) 2 kilos (B) 3 kilos (C) 4 kilos (D) 5 kilos (E) 6 kilos

7. //Cila është vlera më e vogël e mundshme e shprehjes $KA+HI+AP+OO$, në qoftë se shkronjave të njëjta i korrespondojnë shifra të njëjta, ndërsa shkronjave të ndryshme i korrespondojnë shifra të ndryshme?

- (A) 114 (B) 112 (C) 108 (D) 106 (E) 100

8.//60 pllaka të barabarta midis tyre janë të vendosura njëra pranë tjetrës në rresht. Doki e heq çdo pllakë të gjashtë. Më pas Beki e heq çdo pllakë të pestë. Pastaj vjen Deki dhe e heq çdo pllakë të katërt. Pastaj Aneta i heq të gjitha pllakat që kishin mbetur. Sa pllaka hoqi Aneta?


- (A) 0 (B) 10 (C) 30 (D) 40 (E) 50

9.//Njëzet e pesë karta vendosen në tavolinë, kështu që çdo kartë është me faqen e saj të bardhë sipër dhe me të zezën nga poshtë. Doki kreu 25 hapat e mëposhtme. Në hapin e parë Doki e përmbysi vetëm kartën e parë nga e majta. Në hapin e dytë Doki i përmbysi dy kartat e para nga e majta. Në hapin e tretë, Doki, i përmbysi tre kartat e para nga e majta, dhe kështu me rradhë. Në të fundit, hapin e 25-të, Doki i përmbysi të gjitha kartat. Sa karta mbeten me faqen e bardhë sipër, pas përmbysjes së 25-të të fundit të të gjitha kartave?

- (A) 7 (B) 12 (C) 13 (D) 19 (E) 24

10. Pavli ka një fletë drejtkëndëshe e cila është e ndarë në tre drejtkëndësja identikë dhe e ngjyrosur nga të dyja anët (shiko vizatimin). Ai e palos letrën siç është treguar në vizatim (në fillim palos nga e djathta, pa nga e majta dhe në fund e palos në gjysëm). Më pas drejtkëndëshin e formuar e pret sipas diagonales në gjysëm.

Sa pjesë njëngjyreshe do të fitojë Pavli?




- (A) 3 (B) 4 (C) 2 (D) 0 (E) 1

11.//Tetë lojtarë (garues) marrin pjesë në një turne. Për ndeshjet e tyre të para ata janë renditur sipas një zgjedhjeje të rastësishme në katër çifte lojtarësh. Pastaj katër fituesit shpërndahen sipas një zgjedhjeje të rastësishme në dy çifte që luajnë midis tyre. Prej tyre, dy fituesit luajnë ndeshjen finale. N.q.s. supozojmë që në çdo ndeshje fiton lojtari më i fortë, atëherë sa lojtarë janë më të dobët se lojtari që fiton vendin e dytë?

- (A) 7 (B) 6 (C) 5 (D) 4 (E) 3

12. Numrat nga 1 deri në 6 janë shkruar në rrathët e trekëndëshit. Në çdo rreth nga një numër. Numri i shkruar në secilin trekëndësh është numër që është fituar me shumëzimin e numrave që ndodhen në rrathët e kulmeve të tij. Sa është shuma e numrave të shkruar në rrathët e kuq?

- (A) 8 (B) 11 (C) 12
(D) 13 (E) 14




13. Skema katore me dimensione 3x4 mbushet me numrat nga 1 deri në 12, kështu që çdo numër shkruhet në një katror. Dy numra të njëpasnjëshëm duhet të jenë shkruar në katrorë që kanë një brinjë të përbashkët. Numrat 1 dhe 12 janë shkruar tashmë. Cili numër duhet të

1			
	12		






shkruhet në katrorin gri?

- (A) 10 (B) 9 (C) 8 (D) 7 (E) 6

14. Zoti Miks ka një skemë drejtkëndëshe katrore me dimensione 6x8 të cilën duhet ta plotësojë me domino 1x2. Duke vepruar kështu, tre domino janë vendosur tashmë. Dominot e mbetura, në fushat e mbetura boshe, mund t'i vendosë dhe të njëjtat nuk lejohet të mbivendosen por mund të rrotullohen. Pas plotësimit të skemës, si do të duken dominotë e



vendosura në katrorin e shënuar me të verdhë?



15. Doki pret një fletë letre drejtkëndëshe dhe fiton dy drejtkëndësha të rinj (shiko vizatimin). Perimetrat e drejtkëndëshit fillestar dhe dy drejtkëndëshave të rinj janë 17,31 dhe 40, në njëfarë renditjeje. Sa është suprina e drejtkëndëshit original(fillestar)?

- (A) 64 (B) 75 (C) 84
(D) 91 (E) 96

